Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Milaim Sylejmani	**22.09.2026**	**23.09.2026**	**2026/0718**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.09.2026, OE "2A Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0718, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ""Mirembajtja verore e rrugeve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujembledhesve)" – e ndare ne VI- LOT-e" me nr. të prokurimit: "616-26-6509-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,750,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-26-6509-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **"Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve)" – e ndarë në VI- LOT-e**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

OE "2A Group SHPK"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Ali Pashe Tepelena,IVY Residence,1/14
(Adresa)

PRISHTINË *(Vendi)*

10000 *(Kodi postar)*

+383 48666691 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Kushtrim Krivaqa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@2a-ks.com
(Adresa elektronike)

18.09.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

1/12

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 12.08.2026.

Hapja e tenderëve është ri-paraparë për tu bërë me datë 21.09.2026.

Pas disa ndryshimeve që AK i ka bërë si rezultat i ankesave dhe pyetjeve nga OE, dosja e tenderit ka pësuar disa ndryshime por prap në të kanë mbetur kërkesa kufizuese dhe pengim të konkurrencës së lirë

Të pakënaqur me kriteret dhe kërkesat të dosjes së tenderit si dhe për mos respektim të ligjit nga ana e AK-së, me datë 04.09.2026 iu kemi drejt AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 08.09.2026 ka publikuar vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur e këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriter vlerësimi është tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët të ppentuar.**

2/12

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderëve nuk është bërë akoma dhe e njëjta është ri-caktuar të bëhet me datë 21.09.2026.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Hapja e tenderëve është ri-paraparë për tu bërë me datë 21.09.2026.

Pas disa ndryshimeve që AK i ka bërë si rezultat i ankesave dhe pyetjeve nga OE, dosja e tenderit ka pësuar disa ndryshime por prap në të kanë mbetur kërkesa kufizuese dhe pengim të konkurrencës së lirë

Të pakënaqur me kriteret dhe kërkesat të dosjes së tenderit si dhe për mos respektim të ligjit nga ana e AK-së, me datë 04.09.2026 iu kemi drejt AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 08.09.2026 ka publikuar vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur e këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

3/12

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 4 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 17 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 18 të RRPP-së,

AK ka shkelur nenin 71 të LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë hartimit të kritereve dhe kërkesave për tenderuesit ka aplikuar kritere që ndikojnë shumë negativisht në drejtim të shfrytëzueshmërisë së mjeteve në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Thënë shtruar, AK ka aplikuar disa kërkesa dhe nivele të plotësimit të tyre në të njëjtën kohë deri në (60%) për liderët e grupeve duke atakuar drejt për drejt efikasitetin dhe ekonomicitetin e shpenzimit të parasë publike si dhe duke atakuar njëkohësisht edhe nenin 71 të LPP-së i cili ua mundëson OE-ve që të futen si Grup të OE-ve në realizimin e kontratave të ndryshme. Përpos kësaj ky AK ka vendosur edhe kritere kufizuese teknike tek pajisjet e nevojshme për realizim të kontratës që shpesh bien në kontradikta të forta me njëra me tjetrën. P.SH. edhe pse pajisjet kanë me u përdorë për operim në një shesh, fushë apo hapësirë të njëjtë, njërës pajisje ja ka vendosur kufirin e peshës maksimale shumë të ulët ndërsa tjetrës shumë të lartë edhe pse të dyja kanë me operuar në të njëjtin vend. Pse u dashka që të kërkohet Fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale min 7 deri max 12 ton ndërsa në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend ka me operuar edhe Kamioni (cisternë) speciale me kapacitet (min 9,000 max 20,000) Litra që arrin peshën nga 15 ton deri 30 ton. Pra cili është efekti i kufizimit të peshës maksimale në 12 ton për fshesën kur në të njëjtën hapësirë ka me operuar cisterna me peshë të mundshme deri në 30 ton. Kjo po shihet qartë se është bërë vetëm për kufizim të konkurrencës me efekt favorizimin e OE-ve

4/12

që AK paraprakisht ua ka shikuar pajisjet dhe kapacitetet e peshave të tyre. AK shkon aq larg sa që për nivele të rrugëve të njëjta me kapacitet bartës të njëjtë, diku vendosë pesha më të vogla e diku shumë më të larta, që tregon se përmes favorizimeve të tilla edhe ua ka nda Lot-et OE-ve të caktuar në përputhje me kapacitetet teknike që ata i posedojnë. Aty ku operon fshesa 12 ton, mund të operoj edhe fshesa 13 ton me që në të njëjtin vend operon cisterna me 30 ton çfarë rëndësie ka a është pesha e fshesës 12 apo 15 ton, prandaj kjo tregon hapur se ka kufizime të koordinuara me qëllim favorizimin e OE-ve të caktuar.

Përpos krejt këtyre, AK ka bërë kufizime edhe tek dokumentacioni dëshmues i pajisjeve me që ka kërkuar që ato të dëshmohen me libreza të regjistrimit me validitet ose për disa edhe me DUD-a doganor. Fillimisht këtu ka bërë kufizim në detyrim të panevojshëm të regjistrimit të pajisjeve para se të fitohet kontrata e që shpenzimi i tillë ndikon direkt në rritjen e kostos për AK-në sepse kosto e tillë reflekton tek çmimet që do ofrohen. Përpos kësaj ka bërë kufizime edhe kur për disa pajisje ka kërkuar DUD-a doganor që tregon se drejt për drejt ua ka kufizuar pjesëmarrjen kompanive që për momentin operojnë në shtetet tjera. Pra edhe pse tenderi është tender i madh me mundësi të tenderimit edhe kompanitë nga jashtë Kosovës, përmes kërkesës për DUD-a doganor, atyre ua ka pamundësuar pjesëmarrjen në këtë aktivitet. Për ta plotësuar këtë dhe për të dëshmuar se veprimet e tilla janë në kundërshtim të plotë me nenin 1 dhe 6 të LPP-së, po i paraqesim dy dispozita decidive që e ndalojnë veprimin e tillë kufizues dhe favorizues të AK-së:

Neni 1
Qëllimi

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6
Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe krahasuar me atë që e thonë këto dy dispozita, lehtë konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së duke **mos** vendosur kritere në përputhje me ligjin dhe rregulloren e prokurimit dhe nga ku shihet se kërkesat e tilla janë diskriminuese për shumicën e OE-ve dhe favorizim i hapur i disa OE-ve të caktuar.

5/12

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjate hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kritereve dhe kërkesave për OE ka vendosur kritere kufizuese për shumicën e OE-ve të cilat në të njëjtën kohë janë favorizuese për disa OE të caktuar që AK ka lidhje me ta. Ky veprim i AK-së bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 27 dhe 69 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për shërbime. LPP dhe RRPP-001/2022 qartë e përcakton që kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga OE duhet të jenë të qarta dhe të paraqiten si kritere minimale, të definuara saktë dhe të jenë të matshme e jo siç i ka vendosur AK-ja në rastin konkret. Bazuar në këtë dhe shikuar me kujdes kërkesën që përpos kritereve tjera Lideri i grupit të ketë 60% të pajisjeve, kërkesa që pajisjet të dëshmohen me libreza valide apo me DUD-a doganor tek disa pajisje si dhe kufizimet në pajisje me pesha minimale dhe maksimale në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin terren veprues, tregon qartë se AK ka bërë qëllimisht kufizim konkurrence duke favorizuar OE të caktuar që fillimisht ua ka shikuar pajisjet që ata posedojnë e mandej ua ka përshtatur kërkesat madje edhe ua ka ndarë Lot-et që potencialisht duhet të i fitojnë e që si veprim bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së.

Pra po shihet qartë se qëllimisht si shumë kërkesa tjera, është lënë edhe kërkesa për posedim të pajisjeve deri në shkallën 60% nga Lideri i grupit vetëm sa për të pasur mundësi të manipulohet me të gjatë vlerësimit e që sipas LPP-së konsiderohet kufizim i plotë i konkurrencës. Përpos krejt kësaj, kjo konsiderohet edhe favorizim i hapur i OE të caktuar dhe njëkohësisht diskriminim i të tjerëve, ku siç e thamë edhe më sipër kriteret e tilla bien plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 4 të RRPP-001/2022 i cili flet për administrimin e mirëfilltë të procedurave të prokurimit dhe luajtjen e rolit aktiv të AK-së në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe ekonomike. Ja si e përshkruan neni 4 i kësaj rregulloreje detyrimin e AK-së për vendosjen e kritereve proporcionale dhe të drejta:

Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive;
b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe
c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

4.2 Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësi në lidhje me ndonjë tenderues ose kandidat, ose pjesëmarrës në një procedurë të prokurimit publik, përveç nëse një vendim për kompenzim të ankuesit është nxjerrë nga Organi Kompetent (OSHP ose Gjykata kompetente).

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Po që se e shikojmë me kujdesë dosjen e tenderit dhe kërkesat e vendosura nga AK e sidomos kriterin që lideri të posedoj 60% të pajisjeve, kriteri që dëshmimi i pajisjeve me libreza valide dhe me DUD-a doganor si dhe kriterin me kufizimet e peshave tek pajisjet nga të dy nivelet, ai minimal dhe ani maksimal tregojnë se AK nuk është duke administruar fare procedurën e prokurimit sipas këtij neni nga çka lirisht mund të themi se edhe e ka shkelur plotësisht nenin 4 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 me rastin e hartimit të dosjes së tenderit sepse ka lënë kërkesa kufizuese edhe përkundër që LPP me dispozitat a tijë ja ndalon një gjë të tillë duke e udhëzuar AK-në për hartim të kritereve në përputhje me frymën dhe parimin e drejtë të prokurimit si dhe rritjes/promovimit së konkurrencës. Vet fakti që AK ka lënë kritere të cilat është jashtëzakonisht vështirë të plotësohen nga një OE i vetëm si dhe janë shumë të kushtueshëm që të plotësohet, e sidomos për ata që duan të aplikojnë në më shumë Lot-e, tregon se hartimi i dosjes është bërë në kundërshtim me ligjin përkatësisht në kundërshtim të plotë me nenin 27 të LPP-së dhe në kundërshtim të plotë me nenin 17 të RRPP-së.
Ja si e përshkruan neni 17.7 i RRPP-së detyrimin e AK-së për hartim të mirëfilltë të dosjes së tenderit:

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Dosja e tenderit që AK e ka krijuar/ndryshuar disa herë i ka shkelur të dyja këto kufizime që kërkesa e rregullores i ndalon andaj s'kemi se si të mendojmë ndryshe përveç se AK e ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022. Në vazhdim po i cekim dhe zbërthejmë detalisht kriteret që AK i ka vendosur duke lënë në përmbajtjen e tyre elementet kufizuese që janë në kundërshtim me ligjin:

❖ **Kërkesa 6 e FDT-së nga pika 9.1&9.2) e sajë:**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kërkesa 6. Operatori ekonomik duhet të posedojë ose të ketë në dispozicion mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm janë të përcaktuara sipas tabelës në Aneksin 8 të DT-se dhe specifikacionit teknik të Dosjes së Tenderit. Në rast konzorciumi Lideri duhet të përmbushë së paku 60% të kërkesës për pajisje, ndërsa pjesa tjetër mund të plotësohet nga anëtarët e tjerë të grupit.**	**Dëshmia 6. -dëshmi për pajisjet dhe mekanizimin e kërkuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë për automjetet që regjistrohen kopje të librezave të qarkullimit, për automjetet që nuk regjistrohen fatura e blerjes, deklarata unike doganore (DUD) ose dokumente të tjera që dëshmojnë posedimin. Në rast se operatori ekonomik nuk është pronar i pajisjeve, ai duhet të paraqesë edhe marrëveshje për përdorim, kontratë qiraje ose dokument tjetër ekuivalent që dëshmon se pajisjet janë në dispozicion për realizimin e kontratës . Të gjitha pajisjet e deklaruara duhet të jenë të disponueshme gjatë periudhës së realizimit të kontratës.**

Kundërshtimi i këtij kriteri:

- **Arsyetimi i kundërshtimit** është se Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar që në rast të aplikimit si Grup i OE-ve, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të kërkesës për pajisje dhe mekanizëm obligues. Kjo kërkesë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **Nenit 71 të LPP-së**, i cili u jep të drejtë OE-ve të bashkohen në grupe për të plotësuar dhe bashkuar kapacitetet e tyre teknike dhe profesionale. Përpos kësaj ky kriter realisht mund të vendoset vetëm kur është nevojshme për ndonjë projekt kompleks apo të specializuar dhe atë vetëm për kriterin mbi **gjendjen ekonomike dhe financiare.** Përdorimi i përqindjes (60%) të plotësimit të disa kritereve në të njëjtën kohë nga Lideri dhe atë për një projekt shërbimesh kaq të thjeshtë siç është pastrimi i rrugëve dhe shesheve është plotësisht gabim dhe në kundërshtim me ligjin si dhe në kundërshtim me udhëzuesin e prokurimit publik.

- **Ja edhe kufizimi i konkurrencës që ndodh në aplikim të këtij kriteri:** Qëllimi i vetë ekzistencës së grupeve të OE-ve është që anëtarët e grupit të plotësojnë njëri-tjetrin aty ku kanë mungesa. Vendosja e një pragu të tillë prej 60% specifikisht vetëm për Liderin (*dhe atë jo vetëm për kriterin mbi **gjendjen ekonomike dhe financiare** por edhe për tre elemente tjera*) është plotësisht arbitrare, jo proporcionale me projektin dhe pa asnjë mbështetje në LPP apo në Udhëzuesin e Prokurimit Publik. Kjo kërkesë eliminon pa të drejtë grupet ku anëtarët e tjerë mund posedojnë pajisjet kryesore

8/12

teknike, duke kufizuar kështu pjesëmarrjen dhe konkurrencën në mënyrë jo legjitime dhe në të njëjtën kohë duke favorizuar OE të caktuar që siç po shihet ua ka përshtatur kriteret e tilla madje duke ua përcaktuar paraprakisht edhe Lot-et. Me vet faktin që neni "8.5.v" i UPP-001/2023 e përcakton se kriteri i tillë mundet të vendoset për një përqindje minimale dhe se e përcakton që AK mundet ta vendos këtë përqindje vetëm tek kriteri mbi *gjendjen ekonomike dhe financiare*, tregon se përdorimi i këtij kushti në më shumë se një kriter të dosjes së tenderit siç ka vepruar AK-ja është i kundërligjshëm. Për tu bindur se vendosja e kritereve të tilla është e gabuar, mund të shikohet me kujdesë neni 8.5.v i UPP-001/2023 ku qartë shënohet se në rastet e tilla mundet të kërkohet përqindje e caktuar për liderin dhe atë vetëm tek kriteri mbi gjendjen ekonomike dhe financiare. Ja si duket dispozita në fjalë:

- Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:
Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

Këtu po shihet se është ofruar madje edhe një shembull se si mundet të aplikohet kriteri i tillë andaj bazuar në këtë që thuhet tek dispozita në fjalë, tregohet qartë se kriteret e vendosura nga AK e sidomos përqindja (60%) tek posedimi i pajisjeve janë të jashtëligjshme.

❖ **Kërkesa e Aneksit 8 që pajisjet gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë me librezë dhe me regjistrim valid / disa me DUD-a doganorë:**

Aneksi 8. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PAJISJEVE DHE MEKANIZIMIT TË OBLIGUESHËM

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (copë)
	LLOTO 1	
1.	Fishesa Elektrike –thithëse me vakum për pastrim të trotuareve dhe hapësirave publike . Fshesë elektrike manuale me vakum për përdorim urban. Operim: Elektrik me bateri, pajisur me tub fleksibilitet për thithje të mbeturinave, e përshtatshme për operim nga një person, Autonomi pune: mbi 6 orë. Sistem filtrimi për pluhur, Nivel i ulët zhurme, E përshtatshme për përdorim në trotuare dhe sheshe Gjendje teknike funksionale.	1
2.	Fshesë për pastrimin e shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve me peshë totale min 1.5 deri max 1.9 ton, sistem pastrimi me furça dhe vakum, kapacitet depozitimi min. 240L , gjerësi pune me brusha mbi 1.5 m , rezervuar uji mbi 150L për largimin e pluhurit. Gjendje teknike funksionale ***Vërejtje: Fshisa gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë me librezë dhe me regjistrim valid.***	1
3.	Fshesë kompakte për pastrimin e trotuareve, rrugëve urbane dhe hapësirave publike me peshë totale min 2.0 deri max 2.7 ton, sistem pastrimi me furça dhe vakum, Gjendje teknike funksionale ***Vërejtje: Fshisa gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë me librezë dhe me regjistrim valid.***	1

Kundërshtimi i këtij kriteri:

- **Arsyetimi i kundërshtimit -** AK kërkon që të gjitha pajisjet e ofertuara të posedojnë regjistrim valid dhe librezë gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Kjo kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 7 dhe Nenin 28 të LPP-së**, sepse u ngarkon OE-ve barrë financiare administrative të panevojshme dhe jo proporcionale me natyrën e shërbimit përpara se të shpallen fitues të kontratës.

- **Ja edhe kufizimi i konkurrencës që ndodh në aplikim të këtij kriteri:** Regjistrimi i mjetit apo validiteti i lejeve/librezave në fazën e tenderimit nuk përbën garanci për cilësinë e ekzekutimit të punëve në të ardhmen, pasi kontrata ende nuk është nënshkruar. Praktika e mirë e prokurimit dhe udhëzimet e KRPP-së përcaktojnë se gjatë ofertimit mjafton dëshmia e pronësisë, marrëveshja e qirasë ose deklarata e disponueshmërisë së pajisjeve, ndërsa vlefshmëria e regjistrimit apo inspektimit teknik të mjeteve duhet të kërkohet si kusht për fillimin e punimeve pas nënshkrimit të kontratës. Kushtëzimi me regjistrimet aktuale/valide që në ofertim i s'kualifikon pa të drejtë OE-të është kundër ligjore sepse ata që posedojnë mjetet është e pa drejtë të i detyrosh për shpenzim në regjistrim ku ato munden të i regjistrojnë/riaktivizojnë vetëm nëse e marrin kontratën dhe në momentin kur angazhohen në projekt.

❖ **Kërkesa e Aneksit 8 me dy kufizime (min dhe max) në kapacitet teknik(peshë, litrazhë apo presion, etj), P.SH.:**

5.	Fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale min 7 deri max 12 ton : sistem pastrimi me furça dhe vakum me fuqi të lartë , e përshtatshme për përdorim në rrugë me trafik të lartë, gjendje teknike funksionale.

Kundërshtimi i këtij kriteri për pragun Minimal dhe Maksimal:

- **Arsyetimi i kundërshtimit:** Në Aneksin 8, për pjesën më të madhe të pajisjeve, AK ka vendosur kufizime të dyfishta siç e paraqitëm më sipër – duke përcaktuar si parametrin **minimum**, ashtu edhe atë **maksimum** të kapaciteteve teknike të pajisjeve. Kjo metodë e kufizimit të panevojshëm të të dy limiteve përbën shkelje flagrante të **Nenit 28 të LPP-së [Specifikimet Teknike]**, i cili kërkon që specifikimet të mundësojnë qasje të barabartë dhe të mos krijojnë pengesa të panevojshme dhe të pajustifikueshme.

- **Ja edhe kufizimi i konkurrencës që ndodh në aplikim të këtij kriteri:** Përcaktimi i një tavan-i (kufirit maksimal) për kapacitetet e një pajisjeje (*p.sh. pesha, litrazha, fuqia e motorit apo përmasat*) nuk ka asnjë arsyetim logjik e aq më pak arsyetim teknik të punës së tyre. Nëse një OE ofron një pajisje me kapacitet më të lartë se minimumi i kërkuar nga AK, kjo vetëm sa lehtëson dhe përshpejton kryerjen e shërbimeve andaj kufizimi i tillë pa asnjë arsyetim të bazuar përbën kufizim enorm të konkurrencës. Pra po shihet qartë se vendosja e kufirit maksimal shërben vetëm si filtër diskriminues për të eliminuar ofertuesit e tjerë dhe për t'i përshtatur specifikimet teknike fiks për mjetet e një OE-je të caktuar, gjë që si veprim është e ndaluar rreptësishtë nga LPP-ja por edhe nga RRPP-001/2022.

Nisur nga krejt kjo që thamë më lartë shihet qartë se AK ka kufizua tej masë konkurrencën duke hartuar dosje të tenderit në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregulloren e prokurimit andaj me të drejtë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1, 6, 7, 27 dhe 28 të LPP-së, si dhe ka shkelur plotësisht edhe nenin 4, 17 dhe 18 të RRPP-001/2022.

Përpos këtyre neneve të cekura, AK ka shkelur plotësisht edhe nenin 71 të LPP-së dhe nenin 26 të RRPP-001/2022. Shkelja e tillë vjen si pasojë e asaj që edhe përkundër se këto dispozita u japin të drejtë OE-ve të organizohen në grupe për të plotësuar kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit, AK po e bllokon një gjë të tillë duke ua përcaktuar se si duhet të organizohen grupet e tilla me të vetmin qëllim favorizimin e OE-ve të caktuar që tashmë po shihet që u janë përshtatur komplet specifikimet teknike të kapaciteteve që ata i posedojnë. Kjo shkon aq larg sa që në asnjë Lot nuk janë kërkesat e njëjta për nga kapaciteti dhe për nga lloji i tyre edhe pse natyra e punëve nëpër Lot-e është pothuajse e njëjtë. Kjo edhe më shumë po tregon se AK ka hartuar kritere dhe kërkesa në koordinim me disa OE të caktuar ku fillimisht i ka marrë informatat mbi kapacitetet e tyre e pastaj i ka ndarë si kritere nëpër Lot-e varësisht nga lloji dhe niveli i kapaciteteve që këta OE posedojnë.
Pas krejt kësaj dhe të gjitha argumentimeve që u dhanë më sipër, po shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 71 të LPP-së dhe nenin 26 të RRPP-001/2022 andaj kërkojmë nga OSHP që të analizoj me kujdesë kriteret e tilla dhe përmes një vendimi detyrues ta obligoj AK-në në ri-hartim të kritereve dhe kërkesave në përputhje të plotë me ligjin duke promovuar konkurrencë të barabartë dhe shfrytëzim efikas, efektiv dhe ekonomik të parasë publike.

11/12

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të shqyrtoj me kujdesë pretendimin tonë dhe të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e **OE "2A Group SHPK "** lidhur me tenderin **"Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve)" – e ndarë në VI- LOT-e** i iniciuar nga **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

ANULOHET njoftimi për kontratë i **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**
AK të angazhohet seriozisht dhe të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit, sidomos kërkesën 6 nga pika (9.1&9.2 e FDT-së), kriterin për dëshmitë e pajisjeve dhe kufizimet e panevojshme në kapacitetin e pajisjeve që i cekëm më sipër, e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë.

9. Dëmet materiale
Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

